АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ



NEWSLETTER

Tetor 2026 **Nr.10**

Muhamer Beqiri mori detyrin e zëvendësit të drejtorit të AShMA-së



Muhamer Beqiri më 9 tetor mori detyrën e zëvendësit të drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Me këtë rast, Kryetari i Këshillit të Agjencisë, mr. Sasho Sefanovski dhe zëvendësja e kryetarit të Këshillit mr. Zirjeta Jajaga, i dorëzuan kontratën për punësim. Zëvendësi i drejtorit të Agjencisë u zgjodh në seancën e 33-të të Këshillit të Agjencisë, të mbajtur me datë 5 tetor 2026, me mandat prej 5 (pesë) vitesh.

Takim dypalësh ndërmjet përfaqësuesve të AShMA-së dhe rregullatorit Turk të RTUK-së



Kryetari i Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (AShMA-së), mr. Sasho Stefanovski, më 13 tetor 2026, u takua me delegacionin e Këshillit Suprem për Radio dhe Televizion të Republikës së Turqisë (RTUK), të udhëhequr nga kryetari Mehmet Danish.

Në takim u diskutua për sfidat e rregullatorit mediatik, me theks të veçantë për mbrojtjen e të miturve, rregullimin e platformave digjitale, arsimimin mediatik dhe ndikimin e inteligjencës artificiale, si dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy trupave rregullator. Vizita u realizua në kuadër të Punëtorisë së 15-të Ndërkombëtare „Komunikimi me të Ardhmen“, kushtuar etikës në media dhe sovranitetit digjital në epokën e inteligjencës artificiale, të organizuar nga RTUK dhe Universitetit Ndëkombëtar Ballkanik.

U mbajtën Ditët e Arsimimit Mediatik 2026



Nga 26 tetor deri më 2 nëntor, u mbajtën Ditët e Arsimimit Mediatik 2026, të organizuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rrjetit për Arsimim Mediatik, me të cilën vendi për herë të tetë iu bashkua shënjmit të Javës Globale të Arsimimit Mediatik dhe Informativ të UNECKO.

Manifestimi u mbajt nën moton „Të gjithë kemi një rol“, dhe në kuadër të tij u organizuan punëtori, ligjërata dhe aktivitete të tjera në disa qytete në të gjithë vendin, që synojnë zhvillimin e të menduarit kritik, njohjen e dezinformimit dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive digjitale, me theks të veçantë te të rinjtë dhe kategoritë e cenueshme të qytetarëve.

Zgjedhjet e parakohshme për kryetar të komunës së Brvenicës

Në tetor vazhduan aktivitetet e Agjencisë lidhur me zgjedhjet e parakohshme për kryetar të komunës së Brvenicës. Vazhdoi monitorimi i prezantimit mediatik zgjedhor të transmetuesve, ndërsa mediave kombëtare dhe mediave programi i të cilave mund të ndiqet në territorin e komunës së Brvenicës iu dorëzuan shkresa, duke i përkujtuar për detyrimet që vlejnë gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore në rrethin e parë dhe të dytë të procesit zgjedhor.

Gjatë mbikëqyrjes mbi prezantimin mediatik zgjedhor të programit të Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIOTELEVIZIONI i MAQEDONISË Shkup, Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1) më 17 dhe më 18 tetor 2026, u konstatuan shkelje të nenit 76-b, paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a, paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor. Në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, Ndërmarrja Publike Radiodifuzive RADIOTELEVIZIONI i MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), më 17 dhe më 18 tetor, ka transmetuar dy emisione reprizë dhe një premierë në të cilën u realizuan intervista me bartës të funksioneve(funksioner) të organeve qeveritare (Mirosllav Ljabudoviq, Zëvendës – Ministër i Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale, me Goran Gerasimovski, kryetar i Komunës Qendër dhe me Dimitar Kovaçevski, deputet në Kuvendin e RMV-së nga radhët e partisë së LSDM-së). Raporti nga mbikëqyrja mbi prezantimin mediatik zgjedhor është i disponueshëm në link. Për shkeljet e kryera nga RADIOTELEVIZIONI i MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), është inicuar procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente.

Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2025

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 6 tetor publikoi Analizën e Tregut për vitin 2025, me të cilën perceptohet gjendja në industrinë mediatike, qëndrueshmërinë financiare të televizioneve dhe radiostacioneve dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm.

Analiza përfshin të ardhurat, shpenzimet, rezultatet financiare dhe numrin e të punësuarve tek transmetuesit, me periudhë krahasuese nga viti 2020 deri në vitin 2025, me qëllim përcaktimin e trendeve të tregut dhe ndryshimet në punën e mediave. Analiza e Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 është i disponueshëm në linkun e mëposhtëm.

АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ



NEWSLETTER

NJOFTIM PUBLIK

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 15 tetor, nëpërmjet një njoftimi për shtyp, shprehu shqetësim për kërcënimet drejtuar ndaj gazetarëve Aleksandar Mitovski dhe Millosh Milloshevski përmes rrjetit social Facebook, përfshirë dhe fotomontazhin e publikuar me përmbajtje shqetësuese dhe mesazh kërcënues.

Në njoftim u theksua se keqpërdorimi i rrjeteve sociale për të frikësuar dhe ushtruar presion mbi gazetarët është absolutisht i papranueshëm dhe paraqet kërcënim seroiz për sigurinë e tyre, si dhe për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias. Qëndrimet e ndryshme dhe mosmarrëveshjet në raportimin mediatik nuk duhet të jenë arsye për kërcënime, presion ose tentativë për të heshtur gazetarët. Siguria e tyre dhe kryerja papengesë e detyrave profesionale janë thelbësore për gazetarinë e lirë dhe të pavarur.

MBIKËQYRJA MBI TRANSMETUESIT, OPERATORËT E RRJETEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE MEDIAVE TË SHTYPIT

Transmetuesit

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi TV Sitel, për detyrimin e përmbushjes së kushteve kadrovike. Nga mbikëqyrja u konstatua se TV Sitel i përmbush kushtet minimale teknike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Mbikëqyrje të rregullta administrative për përmbushjen e detyrimeve të nenit 62, paragrafi (6), neni 21 LShMAAV-së dhe nenin 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, janë kryer mbi radiot Bleta, Tajm, Buba Mara Prilep, Buba Mara Shkup, Buba Mara Shtip, Kiss, Meff, Rosa AB, Urban, Golldi, Zona M1, Kanal 77, Merak 5 FM, RFM, Fortuna, Radio 7, Akord, Aleksandar Makedonski, Antena 5, Vallandovë, Enxhels, Marija Bllagovest, Metripolis, Pela, Plus Forte dhe televizionet Koha, Kanal 5, Kompani 21-M, Koçani-LD, Nahsa TV, Era, Tera, Shenja, 24 Vesti, Alsat-M, M-Net HD, Plus, Svet dhe Festa. Gjatë mbikëqyrjeve u konstatua se transmetuesit i përmbushin kushtet minimale kadrovike të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

ORRPKE

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullta programore mbi operatorët Drim Sat IPTV, Nafi dhe Beko, Skupi Kable, Kabel-Net, Glloballsat, Transhped Trejd, KDS Kabel Net dhe Kablekall për detyrimin në paketën programore që ritransmetojnë detyrimisht dhe papagesë për të ofruar shërbime programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programve që ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjeve nuk u konstatuan shkelje.

Mediat e shtypit

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi botuesit e medias së shtypit: REPRO PRINT ShPKNjP botues i “Nova Makedonija“; SLLOBODEN PEÇAT botues i „Slloboden peçat“; VEÇER PRES botues në “Veçer“; KOHA PRODUCTION botues në „Koha“; MEDIA PLUS FOKUS botues në „Fokus“; ATV MEDIA KOMPANI botues në „Lajm“; JENI BALLKAN botues në “Bahçe“; EURO-MAK KOMPANI botues në „Ekonomija i Biznis“; BIRO EC botues në „Porta 3“; KLIKER MARKETING botues në “INStore“; NARODEN LEKAR (Mjeku Populllor) botues në “Naroden lekar“; MEDIUM BOJA 43 botues në “Shtipski gllas“, KOLOR MEDIA PLUS botues i “Ubavina i zdravje“(Bukuria dhe shëndeti), ENIT PRES PLUS botues në “Zenit“ dhe INOVATOR JSMS TESLA botues i “BALLKANiUM“.

Lënda e mbikëqyrjes ishte detyrimi sipas nenit 14, paragrafi (1) të Ligjit për Media, i cili i referohet publikimit të të dhënave mbi emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias emrin dhe mbiemrin e kryeredaktorit, përkatësisht redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur bëhet fjalë për media të shtypit. Mbikëqyrja tregoi se detyrimi është përmbushur plotësisht nga të gjitha mediat e shtypit.

Masat e shqiptuara paralajmërim publik

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 34-ët të mbajtur më 20 tetor, shqiptoi tre masa paralajmërim publik ndaj TV News Kumanovë, për shkak se televizioni nuk ka përmbushur detyrimin për transmetim së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, nuk ka ofruar informacionet e detyrueshme për përdoruesit, dhe nuk i publikoi të dhënat për impresium për çdo përmbajtje programore në veçanti.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 36-të të mbajtur më 27 tetor, shqiptoi dy masa paralajmërim publik për TV Due, për shkak të mospërmbushjes të detyrimit për transmetim së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase dhe mospublikim të të dhënave për impresium në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje programore në veçanti.

АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
ул. Македонија бр. 38, 1000 Скопје
тел. (02) 3103400 факс: (02) 3103401
е-пошта: contact@avmu.mk веб страница: www.avmu.mk

INTERCERT system certification
ISO 9001: 2015 CERTIFIED
Q-028/2018